



AA.nr.417/2016

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Ragip Namani dhe Gani Avdiu, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Nezir Surdulli, nga Gjilani, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë - Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit lidhur me çështjen e pensionit me aftësi të kufizuar, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.53/2015 të datës 26.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit Nezir Surdulli, nga Gjilani ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.53/2015 i datës 26.10.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.53/2015 të datës 26.10.2016, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit Nezir Surdulli, nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës në Prishtinë, me nr.6000046 të datës 25.09.2014.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë i autorizuari i paditësit av.Shevqet Xhelili, nga Gjilani, për shkak të: shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Duke pohuar se ka pasur prova dhe dëshmi të nevojshme se është shurdhë memec përkatësisht person me aftësi të kufizuar. Andaj propozon që aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, të ndryshohet dhe të aprovohet si e bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe të anulohet vendimi i të paditurës MPMS-DAP nr.6000046 i datës 25.09.2014 dhe paditësit konform nenit 3.2 pika a) të Ligjit 2003/23 për pensione të personave me aftësi të kufizuar ti njihet e drejta në pension si person me aftësi të kufizuar dhe atë prej datës 06.05.2014, ose të merret aktvendim me ç ‘rast i njëjti aktgjykim të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:




Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.53/2015 të datës 26.10.2016, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar, dhe është vërtetuar aktvendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës së Pensioneve në Prishtinë, me nr. 6000046 i datës 25.09.2014, me të cilën ankuesit iu ka refuzuar ankesa për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar dhe vërtetohet vendimi i komisionit mjekësor të shkallës së parë si plotësisht i bazuar konform Ligjit nr.2003/23.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, duke u bazuar në provat siç janë: aktvendimi nr. 6000046 të datës 25.09.2014, përgjigja në padi e datës 01.08.2016, vlerësimi i komisionit mjekësor i i datës 27.06.2014, shqyrtimi i ankesave i datës 16.09.2014, vendimi i të paditurës i datës 10.07.2014, raportet mjekësore të paditësit të datës 24.01.2011, 30.04.2014, 28.04.2014 dhe 06.05.2014, kontrata e punës nr.213 e datës 23.03.2011, vendimi mbi themelimin e marrëdhënies së punës nr.7085/6 e datës 22.11.1979, vendimi mbi caktimin e bazës për të ardhurat personale nr.4430/22 e datës 19.07. viti i pa lexueshëm, vendimi mbi radhitjen e punëtoreve mbi detyrat tjera punonjëse nr.4633/44 e datës 21.07.1987, vendimi nr.4845/2 i datës 09.08.1993, vendimi nr.3140 i datës 12.05. viti i palexueshëm, si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Andaj duke u bazuar në provat e cekura më lartë dokumentacioni mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës, vlerësimin e komisionit të shkallës së parë të datës 27.06.2014, gjykata e shkallës së parë, pasi që ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme mjekësore për të qenë përzgjedhës i pensionit me aftësi të kufizuar, për më tepër se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune deri kur i është ndërprerë për shkak të rrethanave tjera e jo për ato shëndetësore, respektivisht pa aftësisë fizike apo psikike të paditësit, vendosi që ta refuzoj padinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar,

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së.

Nga provat e administruara rezulton se me konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë, i cili në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe kontrollit të paditësit ka konstatuar se i njëjti nuk i përmbush kriteret e parapara me ligj për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar. Në procedurën sipas ankesës, organi i paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin e komisionit ekspert mjekësor të shkallës së dytë, të datës 16.09.2014, për vlerësimin e mendimit të komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë, për personat me aftësi të kufizuar, i cili pajtohet me konstatimin e komisioneve mjekësore të dhëna më parë. Prandaj me vendimin e kontestuar e refuzon si të pa bazuar ankesën e paditësit. Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuar, drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit nr.2003/23, për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në



Kosovë, se te paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme. Prandaj gjykata e shkallës së parë me provat e administruara drejt ka vepruar kur e ka refuzuar padinë e paditësit si të pabazuar, nga se është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbush kriteret për të qenë shfrytëzues të personave me aftësi të kufizuar të plotë dhe të përhershme.

Meqë ankuesi me pretendime të tjera ankimore se është person me aftësi të kufizuar e cila mund të vërtetohet pa pasur ndonjë vlerësim të komisionit mjekësor sepse dihet nga shkenca mjekësore se shurdhë memecet janë një kategori e aftësisë së kufizuar e cila deri më tani nuk ka shërim, nuk e ka vu në dyshim çështjen e vërtetuar faktike nga organi i paditur dhe gjykata e shkallës së parë. Ngase ankuesi nuk ka argumentuar me asnjë provë se komisioni mjekësor në kuadër të paditurës ka qenë i njëanshëm dhe jo objektiv, meqë që nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbush kriteret për të qenë shfrytëzues i pensionit me aftësi të kufizuara. Prandaj kjo gjykatë në tërësi i ka pranuar si të drejta arsyet juridike me të cilën është udhëhequr gjykata e shkallës së parë gjatë nxjerrjes së aktgjykimit të kundërshtuar.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.417/2016, me datë 16.02.2017



Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi